



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

RAPORT MONITORIMI JANAR – DHJETOR 2024

Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030

www.drejtesia.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Përmbajtjes	2
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024 – 2030, PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2024.	6
II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT	9
III. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS QËLLIMEVE.....	12
I. Qëllimi i Parë i Politikës	12
II. Qëllimi i Dytë i Politikës.....	16
III. Qëllimi i Tretë i Politikës.....	18
IV. Qëllimi i Katërt i Politikës.....	21
IV. KONKLUZIONE	Error! Bookmark not defined.
V. SFIDAT	Error! Bookmark not defined.

SHKURTIME

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore
AP	Avokati i Popullit
AS	Akademia e Sigurisë
ASCK	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
BE	Bashkimi Evropian
CPT	Komiteti për Parandalimin e Torturës
QKEDH	Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHASH	Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
GREVIO	Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
GRETA	Grupi i Ekspertëve mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
INSTAT	Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

KP	Kodi Penal
KPP	Kodi Procedurës Penale
KiE	Këshilli i Evropës
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KL GJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHRF	Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MEVPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
M&V	Monitorim dhe Vlerësim
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKIE	Plani Kombëtar të Integritetit Evropian
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
QPKMR	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
QTI	Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë
RSH	Republika e Shqipërisë
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar

SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dh e Koordinimit të Ndihmës
SPAK	Struktura e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
SthCh	Save the Children
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
TdH	Terre des Homes
UEM	Urdhri Evropian i Mbrojtjes
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UP	Urdhri i Psikologut
UPS	Urdhri i Punonjësit Social
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI MONITORIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2024 – 2030, PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2024.

Këshilli i Ministrave ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për forcimin e sistemit të drejtësisë dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, duke përshtatur legjislacionin vendas me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë. Ky angazhim rrjedh nga procesi i integritetit të Shqipërisë në BE, ku mbrojtja e të drejtave themelore është pjesë e Kapitullit 23 të acquis, dhe Ministria e Drejtësisë (MD) ka rolin kryesor në këtë proces, si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave në fushën e drejtësisë dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Në këtë kuadër, u hartua Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit (SNMVK) për periudhën 2024-2030 e cila është miratuar me vendimin nr. 729, datë 13.12.2023 të këshillit të Ministrave. Kjo strategji dhe dokumentat e saj janë në linjë me strategjinë e BE-së "Për të Drejtat e Viktimave 2020-2025" dhe aktet lidhur me acquis të BE-së për mbrojtjen e viktimave. Ajo përfshin masa të qarta që synojnë fuqizimin e pozitës së viktimave në sistemin penal, duke siguruar që ata të informohen, të kenë qasje në drejtësi, dhe të marrin shërbimet e nevojshme për rehabilitimin. Gjithashtu, SNMVK synon parandalimin e riviktimizimit dhe viktimizimit të dytë të viktimave.

Për zbatimin e strategjisë, janë bërë përpjekje për koordinimin ndërinstitucional dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme për viktimat. Ky proces ka përfshirë edhe perspektivën gjinore, me fokus në mbrojtjen e grave dhe vajzave nga viktimizimi. Strategjia bazohet në analizën e gjendjes aktuale të viktimave të krimit në Shqipëri dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare si Komisioni Evropian, GREVIO, GRETA dhe CPT.

SNMVK lidhet me një sërë strategjish të tjera kombëtare si Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030, Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025, dhe Plan i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave. Ajo përputhet gjithashtu me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe agjendën e integritetit evropian të Shqipërisë.

Ky dokument i ri strategjik është pjesë e angazhimeve të marra në Planin Kombëtar për Integritetin Evropian 2022-2024, në Kapitullin 23, ku theksi vihet tek përmirësimi i legjislacionit që rregullon të drejtat e viktimave dhe forcimi i pozitës së tyre në sistemin e drejtësisë penale.

Raporti vjetor i Monitorimit për janar-dhjetor 2024, mbi zbatimin e SNMVK 2024-2030, është raporti i dytë i monitorimit të zbatimit të SNMVK 2024-2030. Gjatë kësaj periudhe kanë nisur zbatimin 86 aktivitete dhe 33 masa nga institucionet përgjegjëse.

Plani i Veprimit 2024 - 2030, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, konsiston në:

- ✓ 11 objektiva strategjike;
- ✓ 18 indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve;
- ✓ 48 masa;
- ✓ 203 aktivitete.

Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin apo/dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë, nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacioni nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e SNMVK-së. Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2024 – 2030 dhe mbulon progresin gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2024.

Plani i Veprimit 2024-2030, përbëhet nga 11 objektiva dhe përmban në total 48 masa dhe 203 aktivitete. Në analizë janë marrë në konsideratë 33 masa dhe 86 aktivitete, të cilat kanë si periudhë zbatimi vitin 2024. Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të masave të SNMVK bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse për periudhën raportuese. Ministria e Drejtësisë ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë muajit shkurt-mars 2025. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për periudhën janar – dhjetor 2024, rezulton se niveli i zbatimit të masave të Planit të Veprimit është si më poshtë vijon:

Zbatueshmëria e SNMVK në nivel masash për janar-dhjetor 2024			
QP I	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	3	2	1
QP II	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	5	5	3
QP III	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	5	4	0
QP IV	Plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara	Të pazbatuara
	3	1	1

Permbledhje Ekzekutive

4 QËLLIME POLITIKE, 11 OBJEKTIVA SPECIFIKË DHE 33 MASA TË ZBATUESHME GJATË PERIUDHËS JANAR-DHJETOR 2024


QËLLIMI I I POLITIKËS

Fuqizimi i parandalimit dhe raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.



QËLLIMI II I POLITIKËS

Një kuadër ligjor i përafëruar me standardet e parashikuara në direktivat e Bashkimit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të tjera, institucione dhe profesionistë që ofrojnë mbështetje, mbrojtje efektive për viktimat e krimit dhe akses të drejtë të viktimës në një skemë kombëtare të kompensimit




QËLLIMI III I POLITIKËS

Garantimi i të drejtës për informim, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave në proceset penale dhe njohja e viktimave me nevoja mbrojtjeje të veçantë.



QËLLIMI IV I POLITIKËS

Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit mes aktorëve që veprojnë në fushën e mbrojtjes së viktimave të krimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.



II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Hartimi i këtij raporti është rezultat i një procesi të strukturuar dhe gjithëpërfshirës të monitorimit, i cili synon të sigurojë një analizë të qartë dhe të thelluar mbi progresin e arritur, sfidat e hasura dhe rekomandimet për përmirësim. Qasja metodologjike e ndjekur është konceptuar për të garantuar transparencë, objektivitet dhe përfaqësim të saktë të të dhënave dhe gjetjeve kryesore.

Në funksion të një procesi monitorimi të bazuar në evidenca konkrete, Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar komunikime të vazhdueshme dhe të strukturuar me përfaqësuesit e institucioneve të përfshira në Planin e Veprimit. Këto komunikime, të realizuara si në formë verbale ashtu edhe nëpërmjet shkëmbimeve zyrtare, kanë shërbyer për të mbledhur informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve dhe për të siguruar një reflektim të drejtë mbi realitetin në terren.

Në këtë kuadër, gjatë fazës së hartimit të raportit, është mbajtur një bashkëpunim i ngushtë me institucionet kyçe të përfshira në strategji, duke synuar identifikimin e rasteve të suksesit, të cilat dëshmojnë për rezultate të prekshme dhe të matshme. Paralelisht, ky proces ka mundësuar evidentimin e sfidave dhe problematikave kryesore që kanë ndikuar në progresin apo kanë penguar zbatimin efektiv të aktiviteteve të parashikuara.

Qasja metodologjike e raportit ka synuar jo vetëm të pasqyrojë të dhënat në mënyrë analitike dhe objektive, por edhe të ofrojë një bazë të fortë për hartimin e rekomandimeve të cilat do të mundësojnë përmirësime të mëtejshme në implementimin e Planit të Veprimit. Përmes kësaj metodologjie, raporti synon të shërbejë si një mjet i vlefshëm për të orientuar vendimmarrjen dhe për të fuqizuar mekanizmat e përgjegjësisë dhe transparencës në nivel institucional.

Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Ky sektor kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SNMVK 2024-2030) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2024, është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Ministria e Drejtësisë, harton raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SNMVK-së për 7 vitet e ardhshme, raporte të cilat publikohen në linkun: <https://www.drejtesia.gov.al/strategjia-ndersektorale-e-mbrojtjes-se-viktimave-te-krimit-2024-2030/>

Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS

Ministria e Drejtësisë ka hartuar raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS miratuar me vendimin nr.290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS).

Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me Parimet e Mirëqeverisjes

Ky raport është hartuar përputhje me Parimet e Mirëqeverisjes të cilët përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregullt të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi. Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA).

- **Efikasiteti:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, masat, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.
- **Llogaridhënia:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **Rëndësia:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

Mekanizimi i Integruar i Politikave

Sipas Urdhërit Nr.90 datë 01.08.2023 të Kryeministrit “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe riorganizimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar” mekanizmat ndërsektorial tanimë funksionojnë mbi bazën e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNP).

Fazat e ndjekura për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Përgatitja dhe konsolidimi i raportit të monitorimit dhe performancës është një proces i strukturuar që përfshin disa etapa kyçe, të cilat sigurojnë mbledhjen, analizimin dhe prezantimin e saktë të të dhënave. Ky proces është zhvilluar në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes, duke përfshirë institucionet përgjegjëse dhe aktorët e interesuar në secilën fazë.

Fazat kryesore të ndjekura janë si më poshtë:

1. Dërgimi i kërkesës për kontribut

- Më **23 Dhjetor 2024**, është dërguar një kërkesë zyrtare për kontribut tek të gjitha institucionet raportuese, në mënyrë që të sigurohet mbledhja e informacionit të nevojshëm mbi ecurinë e zbatimit të objektivave dhe aktivitetëve të Planit të Veprimit.

2. Publikimi për komente dhe sugjerime

- Më **18 Mars 2025**, drafti fillestar i raportit është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe është shpërndarë tek të gjitha institucionet e përfshira në strategji. Kjo fazë ka pasur për qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga institucionet dhe aktorët e interesuar për të siguruar një reflektim sa më gjithëpërfshirës të situatës së monitoruar.

3. Konsolidimi i raportit

- Pas marrjes dhe analizimit të komenteve të sjella nga institucionet dhe aktorët përkatës, është realizuar konsolidimi i paketës finale duke reflektuar sugjerimet e dhëna dhe duke siguruar një dokument të përmirësuar, të saktë dhe të përditësuar mbi progresin dhe sfidat e evidentuara.

4. Miratimi i raportit të monitorimit

- Në datën xxx, është organizuar mbledhja e Ekipit tematik me institucionet përkatëse për miratimin e raportit, e cila ka shërbyer si një hap final për të konfirmuar vlerësimet dhe konkluzionet e dokumentit.

5. Publikimi i Raportit Vjetor të Monitorimit

- Pas miratimit, raporti përfundimtar është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, duke siguruar akses të plotë për të gjithë aktorët e interesuar dhe publikun, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në procesin e monitorimit të strategjisë.

Ky proces siguron që raportimi i monitorimit të jetë i bazuar në të dhëna të sakta, të jetë gjithëpërfshirës dhe të reflektojë në mënyrë të qartë progresin dhe sfidat në zbatimin e Planit të Veprimit.

Metodologjia e analizimit të të dhënave për Raportin e Monitorimit dhe Performancës

Raporti i Monitorimit ofron një vlerësim të qartë dhe të strukturuar të arritjeve kryesore, duke përdorur një kombinim të metodave analitike për të lehtësuar kuptueshmërinë dhe qartësinë e të dhënave. Kjo përfshin përdorimin e grafikëve, dashboards, tabelave dhe analizave të thelluara për të reflektuar në mënyrë objektive performancën e institucioneve përgjegjëse në zbatimin e masave të Planit të Veprimit.

Për më tepër, raporti siguron një identifikim të saktë të shkallës së performancës për Qëllimet e Politikave dhe Objektivat Specifike (OS), duke ndjekur një qasje të strukturuar për analizën e progresit.

Metodologjia e Vlerësimit të Progresit

Për çdo Qëllim Politik, analiza është realizuar në raport me Objektivat Specifike përkatës. Kjo qasje ka mundësuar një vlerësim të detajuar të secilit objektiv, duke përfshirë:

- Përmbledhjen e rezultateve sasore dhe cilësore të zbatimit të masave përkatëse.
- Analizën e risqeve dhe veprimeve të ndërmarra për adresimin e tyre (kur është e aplikueshme).
- Analizën e treguesve të performancës, bazuar në të dhënat e ofruara nga institucionet përgjegjëse.

Rezultatet mbi zbatimin e masave janë paraqitur në përputhje me numërimin e Planit të Veprimit, duke përdorur një skemë vizuale që reflekton nivelin e përmbushjes së tyre:

- **Ngjyrë e gjelbër:** Masat e zbatuara plotësisht.
- **Ngjyrë e gri:** Masat e zbatuara pjesërisht/në proces.
- **Ngjyrë e kuqe:** Masat e pazbatuara.
- **Ngjyrë e bardhë:** Masat e pazbatueshme, të cilat përfshijnë:
 - Masat që kanë një afat zbatimi që nis pas periudhës aktuale të raportimit.
 - Masat që nuk mund të zbatohen nga institucioni raportues për arsye të jashtme (p.sh. mungesë kompetencash ligjore).

Përcaktimi i Nivelit të Zbatimit dhe Realizimit



Raporti përdor një metodologji të qartë për përcaktimin e nivelit të zbatimit të masave dhe objektivave:

- **Niveli i zbatimit të masave (%)** është ai që ka raportuar secili institucion përgjegjës dhe është evidentuar në kontributet e tyre për çdo masë të Planit të Veprimit.
- **Shkalla e zbatimit të masave** kategorizohet si:
 - **E zbatuar:** Masa është përmbushur plotësisht.
 - **Pjesërisht e zbatuar/Në proces:** Masa ka pasur progres të pjesshëm gjatë periudhës raportuese.
 - **E pazbatuar:** Nuk ka pasur progres apo zhvillim të kësaj mase gjatë periudhës raportuese.
- **Niveli i realizimit të Objektivave Specifikë** llogaritet bazuar në raportin midis masave të zbatuara dhe numrit total të masave të zbatueshme për një objektiv të caktuar.

Niveli i realizimit të Qëllimeve të Politikave llogaritet si mesatarja e përqindjes së realizimit të

III. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS QËLLIMEVE

Qëllimi i Parë i Politikës: Fuqizimi i parandalimit dhe raportimit të krimit përmes informimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit efektiv me publikun dhe viktimave të krimit.



Arritjet kryesore:

Realizimi i Javës Ndërgjegjëse të Publikut për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit

Në kuadër të kësaj strategjie, Ministria e Drejtësisë ka nisur për herë të parë Javën Ndërgjegjëse për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit, e cila u zhvillua në periudhën 15-22 Shkurt 2024 dhe do të organizohet çdo vit.

Kjo fushatë synon:

- Rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi të drejtat e viktimave, mbrojtjen dhe aksesin në shërbimet e dedikuara.
- Fuqizimin e bashkëpunimit mes aktorëve kyç, përfshirë profesionistët e drejtësisë, shoqërinë civile, akademinë, bizneset, organizatat joqeveritare dhe median.
- Sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë vetë grupet e viktimave dhe organizatat që i përfaqësojnë ato.

Në këtë kuadër, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, ka organizuar një sërë aktivitete në nivel kombëtar, me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm institucionalë dhe komunitarë.

Aktivitetet Kryesore të Fushatës

1. Nisja e Fushatës – 6 Shkurt 2024

- Videomesazh nga Ministri i Drejtësisë, duke ftuar të gjithë aktorët të bashkëpunojnë për të mundësuar drejtësi dhe mbrojtje efektive për viktimat e krimit.

2. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile: Qendra “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Terre des Hommes etj organizoi informim të hapur për qytetarët nëpërmjet stendave informuese të vendosura gjithë javën pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe shpërndarjes e broshurave me informacion për qytetarët.

3. Takimi me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë – 16 Shkurt 2024

- Diskutim mbi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe institucioneve shtetërore për mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimave të krimit.

3. Aktivitetet në Lezhë – 17 Shkurt 2024

- Inaugurimi i muralit #NëMbrojtjeTëViktimaveTëKrimit, si një simbol i angazhimit institucional për ndërgjegjësimin mbi këtë çështje.
- Performanca e Teatrit Social Lëvizës: “Drejtësia është miqësore me ty - Ti nuk je Vetëm!” me mesazhe fuqizuese për viktimat.
- Stenda informuese nga Zyra për Ndihmën Ligjore Falas, për të informuar qytetarët mbi shërbimet ligjore të disponueshme për viktimat e krimit.

4. Leksion i Hapur në Universitetin e Elbasanit – 19 Shkurt 2024

- Prezantimi i Strategjisë së Mbrojtjes së Viktimave të Krimit, duke promovuar ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi këtë çështje mes studentëve dhe akademikëve.

5. Konferenca Kombëtare – 21 Shkurt 2024

- Prezantimi i Studimit Kombëtar nga “Together for Life” mbi fuqizimin e vajzave dhe grave, duke trajtuar sfidat dhe mundësitë për fuqizimin socio-ekonomik të viktimave.

6. Tryeza Vendore në Shkodër – 21 Shkurt 2024

- Diskutime mbi drejtësinë për të mitur, duke trajtuar mekanizmat e mbrojtjes dhe sfidat e zbatimit të politikave për këtë kategori vulnerabël.

7. Tryeza Diskutimi në Vlorë – 23 Shkurt 2024

- Takim me Qendrën Psiko-Sociale “Vatra” dhe institucionet lokale, për të analizuar sfidat dhe zgjidhjet për përmirësimin e ndihmës juridike dhe mbështetjes për viktimat e krimit. Në kuadër të Javës për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit në Shqipëri, Vatra prodhoi një fletëpalosje "Informo dhe kërko"1 për të informuar publikun për veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës me bazë gjinore dhe abuzimit seksual.

Përfundime dhe Hapat e Ardhshëm

Kjo nismë ka shënuar një moment kyç në përpjekjet për të fuqizuar mbrojtjen dhe aksesin e viktimave të krimit në drejtësi dhe shërbime të dedikuara. Përmes aktiviteteve të organizuara, është rritur ndërgjegjësimi dhe është forcuar bashkëpunimi mes institucioneve shtetërore, sektorit privat dhe organizatave të shoqërisë civile.

Në vijim, Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë të:

- Monitorojë dhe vlerësojë impaktin e Strategjisë Ndërsektoriale, duke përmirësuar vazhdimisht qasjen dhe zbatimin e saj.
- Thellojë bashkëpunimin me aktorët lokalë dhe ndërkombëtarë, për të garantuar një sistem mbrojtjeje më efikas dhe gjithëpërfshirës.
- Promovojë edukimin dhe informimin e vazhdueshëm, duke përfshirë trajnime për profesionistët dhe aktivitete ndërgjegjëse për publikun e gjerë.

Angazhimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Mbrojtjen e Viktimave dhe Promovimin e të Drejtave

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka vijuar angazhimin e saj të fuqishëm në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës, trafikimit dhe grupeve vulnerabël, përmes një sërë iniciativash institucionale, fushatash ndërgjegjëse dhe shërbimesh të specializuara në nivel kombëtar dhe lokal.

Mbrojtja dhe Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, MSHMS, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF), organizoi një takim gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e 30 fëmijëve nga Shkodra, Elbasani, Tirana, Kamza dhe Burreli.

Objektivat e këtij takimi përfshinin:

- Diskutimin mbi të drejtat e fëmijëve dhe sfidat në zbatimin e tyre.

- Prezantimin dhe shqyrtimin e **Planit të Veprimit** sipas rekomandimeve të Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve.
- Promovimin e një dialogu të hapur mes institucioneve dhe vetë fëmijëve, si pjesë e përpjekjeve për të garantuar pjesëmarrjen aktive të tyre në vendimmarrje.

Shërbimet e Këshillimit dhe Ndhmës për Viktimat

MSHMS ka vijuar forcimin e linjave të ndihmës dhe shërbimeve të këshillimit për viktimat e dhunës dhe grupe të tjera vulnerabël.

ALO 116 111 – Linja Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve

- Organizimi i 5 orëve të hapura informuese në shkolla, ku u përfshinë mbi 350 nxënës dhe mësues në diskutime mbi sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve.
- Zhvillimi i 2 fokus-grupeve me 25 prindër dhe profesionistë psiko-socialë, duke trajtuar sfidat dhe praktikatat më të mira për mbrojtjen e fëmijëve.
- **Statistikat për vitin 2024:**
 - 10,066 telefonata të trajtuara.
 - 181 raste të trajtuara dhe 142 referime për ndihmë.
 - 594 këshillime të ofruara për fëmijët dhe familjet e tyre.
 - 21 raste të raportuara për cyberbullying, me ndërhyrje të specializuara për mbrojtjen e të miturve.

ALO 116 117 – Linja Kombëtare për Gratë dhe Vajzat

- Për vitin **2024**, kjo linjë ka trajtuar **2,272 telefonata**, duke ofruar mbështetje psikologjike dhe referime për gratë dhe vajzat që përballen me dhunë apo diskriminim.

Linja Kombëtare e Këshillimit (Tiranë)

- 1,358 përfitues kanë marrë shërbime të specializuara, duke përfshirë:
 - 540 telefonata këshillimi.
 - 880 raste të trajtuara/referuara për ndihmë të mëtejshme.

Mbështetja për Viktimat e Dhunës dhe Trafikimit

Në kuadër të politikave për fuqizimin e mekanizmave të mbrojtjes për viktimat e dhunës dhe trafikimit, MSHMS ka zgjeruar rrjetin e shërbimeve emergjente dhe strehëzave në disa qytete të vendit.

Shërbimet Emergjente Multifunksionale

- Funksionojnë në 7 bashki: Berat, Maliq, Kukës, Gjirokastrë, Durrës, Dimal dhe Memaliaj, duke mbështetur 1,555 përfitues në vitin 2024.
- 2 shërbime të reja emergjente u krijuan në Dimal dhe Memaliaj, me një financim prej 4,669,060 Lekë, duke rritur mbulimin gjeografik të ndihmës për viktimat.

Strehëzat për Viktimat e Dhunës dhe Trafikimit

- 3 qendra strehimi në Tiranë, Elbasan dhe Vlorë, të cilat kanë asistuar 1,165 përfitues në vitin 2024.
- 1 shërbim rezidencial ditor në Lezhë, i dedikuar grave dhe vajzave në situata vulnerabël, ku kanë përfituar 65 gra dhe vajza.

- Totali i përfituesve nga 11 shërbime të ndryshme: 4,143 viktima të dhunës kanë marrë mbështetje përmes qendrave të specializuara dhe programeve të asistencës.

Fushata dhe Nisma Ndërgjegjëse

Fushata “16 Ditët e Aktivizmit”

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka koordinuar fushatën “16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, e cila ka përfshirë:

- Takime dhe biseda ndërgjegjëse në shkolla dhe komunitete.
- Aktivitete me organizata të shoqërisë civile dhe partnerë strategjikë.
- Fushatë mediatike për të rritur ndërgjegjësimin mbi mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave.

Angazhimi Mediatik

Përfaqësuesit e Linjës Kombëtare për Gratë dhe Vajzat (LKGV) kanë dhënë intervista dhe kanë ndarë ekspertizën e tyre në media mbi:

- Dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.
- Mekanizmat e ndihmës për viktimat dhe mënyrat për të siguruar mbrojtje më efektive.

Konkluzione dhe Hapat e Ardhshëm

Angazhimi i MSHMS në mbrojtjen e viktimave të dhunës dhe trafikimit ka shënuar progres të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe fuqizimin e ndërgjegjësimit publik mbi të drejtat e grupeve vulnerabël.

Prioritetet për të ardhmen përfshijnë:

- Zgjerimin e rrjetit të shërbimeve emergjente dhe strehëzave, për të garantuar akses më të gjerë për viktimat.
- Forcimin e mekanizmave të raportimit dhe ndihmës, duke përmirësuar linjat telefonike të emergjencës dhe këshillimit.
- Rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe angazhimit komunitar, përmes fushatave të dedikuara për mbrojtjen e fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera vulnerabël.
- Përmirësimin e kornizës ligjore dhe politike, për të garantuar që çdo viktima e dhunës të marrë mbështetjen dhe drejtësinë që i takon

Angazhimi i Ministrisë së Brendshme në Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Ministria e Brendshme, në përpjekjet për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ka vënë në dispozicion mekanizma dhe struktura të specializuara për të ofruar mbështetje për viktimat dhe për të forcuar ndërgjegjësimin publik mbi këtë fenomen.

Linjat Kombëtare për Viktimat e Trafikimit

- 116 006 – Linja Kombëtare për Viktimat e Trafikimit në Shqipëri
 - E disponueshme 24/7 gjatë gjithë vitit.
 - Operohet nga Sektori i Antitrafikut, ku një punonjës i specializuar pret dhe menaxhon thirrjet hyrëse nga viktimat e mundshme apo individët që kërkojnë informacion dhe ndihmë.

Fushata Kombëtare Antitrafik “E vërteta N’Ndrit”

Në kuadër të përpjekjeve për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave, Ministria e Brendshme ka lançuar më 23 janar 2024 fushatën “E vërteta N’Ndrit”, si pjesë e programit “Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore”.

Ky program është:

- Financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.
- Zbatuar nga UNICEF Shqipëri, në bashkëpunim me Ambasadën Britanike në Tiranë dhe partnerët zbatues të programit.

Qëllimet e fushatës përfshijnë:

- Parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.
- Mbrojtjen dhe riintegrimin e të mbijetuarve, duke ofruar shërbime mbështetëse për rikthimin e tyre në një jetë të sigurt dhe të qëndrueshme.
- Fuqizimin e partneriteteve antitrafik, përmes bashkëpunimit të ngushtë midis institucioneve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile.

Muaji i Luftës Kundër Trafikimit të Personave – Tetor 2024

Si pjesë e strategjisë kombëtare për ndërgjegjësimin dhe edukimin mbi trafikimin e qenieve njerëzore, Muaji Tetor është shpallur Muaji i Luftës Kundër Trafikimit të Personave. Gjatë kësaj periudhe, janë organizuar një sërë aktivitete në 12 qarqe të vendit, me synimin për të informuar dhe mobilizuar komunitetin në këtë çështje kritike.

Aktivitete Kryesore të Muajit Antitrafik

- Forume dhe sesione informuese me pjesëmarrjen e nxënësve, prindërve dhe profesionistëve, me qëllim edukimin dhe forcimin e masave mbrojtëse ndaj trafikimit.
- Ekspozita rajonale dhe aktivitete me komunitetet vulnerabël, për të nxitur ndërgjegjësimin mbi rreziqet dhe pasojat e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Marshime sensibilizuese dhe shpërndarje materiale informuese, për të promovuar mesazhe mbi parandalimin dhe mekanizmat e mbështetjes për viktimat.

Ngjarja Kryesore: 18 Tetor 2024 në Shkodër

Kulmi i aktiviteteve të Muajit të Luftës Kundër Trafikimit të Personave u zhvillua më **18 tetor 2024 në Shkodër**, ku morën pjesë:

- Institucione qeveritare
- Partnerë ndërkombëtarë dhe organizata joqeveritare
- Shoqëria civile dhe komunitetet vendore

Kjo ngjarje u zhvillua nën sloganin kryesor të fushatës: “Nga ndërgjegjësimi në veprim: Bashkohuni në luftën kundër trafikimit”

Konkluzione dhe Hapat e Ardhshëm

Angazhimi i Ministrisë së Brendshme dhe partnerëve ndërkombëtarë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore synon të:

- Forcojë mekanizmat e raportimit dhe ndihmës për viktimat, duke zgjeruar dhe përmirësuar funksionimin e linjave kombëtare dhe shërbimeve mbështetëse.
- Thellojë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, për të ndërtuar një sistem më të efektshëm për parandalimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit.
- Rrisë ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut, duke vijuar me fushata të dedikuara dhe aktivitete të orientuara drejt grupeve vulnerabël dhe komuniteteve në rrezik.

Roli Proaktiv i Avokatit të Popullit në Promovimin e të Drejtave të Njeriut

Avokati i Popullit ka vijuar të luajë një rol thelbësor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, duke rritur vizibilitetin dhe ndikimin e tij përmes aktiviteteve advokuese, lobimit dhe bashkëpunimit të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile.

Gjatë vitit 2024, institucioni ka zhvilluar një sërë nismash për të fuqizuar ndërgjegjësimin mbi të drejtat e njeriut dhe për të adresuar sfidat kryesore në fushën e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave, me një fokus të veçantë tek dhuna me bazë gjinore.

Aktivitetet Promovuese dhe Sensibilizuese

Në kuadër të angazhimit për edukimin mbi të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit ka organizuar **25 veprimtari promovuese**, duke përfshirë:

- Dita të hapura dhe takime online në institucionet arsimore parauniversitare.
- Bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, për të informuar dhe edukuar të rinjtë mbi të drejtat e tyre dhe mekanizmat mbrojtës që ofron institucioni i Avokatit të Popullit.

Këto veprimtari kanë synuar:

- Rritjen e ndërgjegjësimit tek të rinjtë mbi të drejtat themelore të njeriut dhe rolin e institucioneve të mbrojtjes.
- Nxitjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.
- Forcimin e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e advokacisë dhe lobimit për çështje të të drejtave të njeriut.

Observatori për Femicidet: Një Mekanizëm për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës

Një nga iniciativat më të rëndësishme të vitit 2024 ka qenë **krijimi i Observatorit për Femicidet**, një mekanizëm inovativ monitorimi për vrasjet e grave dhe vajzave, i cili synon të:

- Monitorojë dhe analizojë rastet e femicideve në Shqipëri.
- Parandalojë dhunën ekstreme ndaj grave, duke identifikuar modele dhe faktorë të rrezikut.
- Fuqizojë mbrojtjen e viktimave të dhunës, duke përmirësuar politikat dhe mekanizmat e ndërhyrjes.

Lançimi i Observatorit për Femicidet

Observatori u prezantua për herë të parë në një **tryezë gjithëpërfshirëse**, 8 Mars 2024, ku morën pjesë:

- Institucionet shtetërore të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave.
- Organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga dhuna.
- Ekspertë dhe akademikë, të angazhuar në analizimin dhe vlerësimin e fenomeneve të dhunës dhe femicideve.

Ky mekanizëm do të shërbejë si një instrument i rëndësishëm për analizën dhe advokimin mbi masat parandaluese, si dhe për ndërtimin e politikave më të forta për mbrojtjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore.

Konkluzione dhe Hapat e Ardhshëm

Angazhimi i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2024 ka përforcuar rëndësinë e një qasjeje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në vijim, institucionin e presin disa hapa kyç për fuqizimin e ndikimit të tij:

- Thellimi i edukimit mbi të drejtat e njeriut, duke zgjeruar aktivitetet në më shumë institucione arsimore dhe komunitete.
- Monitorimi dhe ndjekja e femicideve, përmes zhvillimit të mëtejshëm të Observatorit dhe analizave të detajuara mbi fenomenin.
- Zhvillimi i rekomandimeve për politika më efektive, duke përdorur të dhënat e mbledhura për të adresuar sfidat dhe boshllëqet në sistemin e mbrojtjes së viktimave.
- Rritja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, për të siguruar që advokacia dhe lobimi për të drejtat e njeriut të kenë ndikim më të gjerë dhe të matshëm.

Përmes këtyre përpjekjeve, Avokati i Popullit synon të fuqizojë rolin e tij si një mekanizëm kyç në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Roli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Promovimin e të Drejtave dhe Barazisë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) ka luajtur një rol kyç gjatë vitit 2024 në forcimin e mbrojtjes kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë, përmes një qasjeje të bazuar në informim publik, bashkëpunim ndërinstitutional dhe ndërgjegjësim të komuniteteve vulnerabël.

Bashkëpunimi me Median për Ndërgjegjësim dhe Informim

Një nga shtyllat kryesore të angazhimit të KMD ka qenë komunikimi efektiv me publikun përmes mediave. Gjatë vitit 2024, KMD ka realizuar **17 dalje mediatike** me fokus:

- Informimin e viktimave të krimit mbi të drejtat e tyre dhe aksesin në shërbime mbështetëse.
- Adresimin e diskriminimit në sektorë të ndryshëm të shoqërisë.
- Promovimin e barazisë dhe të drejtave të grupeve vulnerabël për të garantuar qasje të barabartë në drejtësi, punësim dhe shërbime sociale.

Pjesëmarrja në Aktivitete dhe Iniciativa për të Drejtat e Njeriut

Gjatë vitit 2024, KMD ka marrë pjesë aktive në një sërë takimesh, seminarësh, trajnimesh dhe grupe pune, duke forcuar bashkëpunimin me institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile për të avancuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Aktivitetet Kryesore të KMD në 2024

- **Shkurt 2024 – Tryezë me Shoqatën "Together for Life"**
 - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi theksoi nevojën për amendimin e legjislacionit mbi ngacmimin seksual në vendin e punës.
 - U diskutua ashpërsimi i dënimeve për ngacmimin seksual, si dhe forcimi i mekanizmave të mbrojtjes për viktimat.

- **Gusht 2024 – Trajnim mbi Parandalimin e Diskriminimit për Viktimat e Trafikimit**
 - Në bashkëpunim me "Terre des Hommes", KMD organizoi një trajnim të specializuar për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.
 - Fokusi ishte në ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, ku të mbijetuarit të mund të integrohen më lehtë në shoqëri dhe të kenë mbështetje adekuate.
- **Tetor 2024 – Takim me Organizatat e P.A.K. (Personat me Aftësi të Kufizuara)**
 - Diskutime mbi dhunën ndaj P.A.K. dhe mungesën e aksesit në shërbime.
 - KMD mori pjesë në marshimin për Ditën Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë, si një akt simbolik për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- **Takime në Korçë dhe Fier – Mbrojtja e Viktimave të Krimit**
 - Takime informuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetin dhe autoritetet lokale.
 - Aktivitete dhe trajnime të dedikuara për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, për të garantuar mbrojtje më efektive dhe qasje të drejtë në shërbime.

Konkluzione dhe Hapat e Ardhshëm

Përmes këtyre aktiviteteve, KMD ka thelluar përfshirjen e tij në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë.

Prioritetet për të ardhmen përfshijnë:

- Forcimin e mekanizmave ligjorë për mbrojtjen nga diskriminimi, veçanërisht në punësim, edukim dhe shërbime publike.
- Zgjerimin e aktiviteteve informuese dhe trajnimeve, për të siguruar që grupet vulnerabël të kenë informacion të qartë mbi të drejtat dhe mekanizmat mbrojtës.
- Ndërgjegjësimin mbi diskriminimin e fshehtë, për të identifikuar dhe trajtuar raste të cilat nuk raportohen për shkak të mungesës së informacionit ose frikës nga pasojat.
- Fuqizimin e rolit të mediave, si një mjet i rëndësishëm për promovimin e barazisë dhe denoncimin e rasteve të diskriminimit.

KMD do të vazhdojë të jetë një zë i fortë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në krijimin e një mjedisi social dhe ligjor më të drejtë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët.

